



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
ZYRA VENDORE ARSIMORE FINIQ-DROPULL

Nr. 150 prot.

Finiq, më 21. 01. 2022

**NJOFTIM PËR PUNËSIM**

**PËR POZICIONIN MËSUES PROFILI Matematikë ose të përafërt.**

**NË AFATIN Janar 2022 deri më 28.02.2022, në SH.M.B. BULARAT**

Në mbështetje të Ligjit 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 31, datë 28.01.2020 “Për Miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore”, udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 të MASR “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, udhëzimit nr.30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve në klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, ndryshuar me udhëzimin Nr.14 datë 28.07.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr.30.”

**ZVAP FINIQ - DROPULL**

**NJOFTON:**

kërkesën për personel mësimor nga **SHKOLLA E MESME E BASHKUAR BULARAT** për pozicionin **mësues** profili Matematikë, si pasojë e krijimit të vendit **vakant** për afatin **Janar 2022 deri 28 Shkurt 2022**.

ZVAP Finiq – Dropull njofton se Komisioni i Vlerësimit në ZVAP Finiq – Dropull do të vijojë me procedurën e duhur ligjore për plotësimin me mësues profili Matematikë në **SHKOLLËN E MESME TË BASHKUAR BULARAT** me kontratë **me afat të caktuar**, sipas Udhëzimit Nr.12 dt 10.05.2021 të MASR “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe administrimin e portalit “Mesues për Shqipërinë”.

Kandidatët e interesuar jashtë portalit, që plotësojnë kërkesat për pozicionin e mësuesit si më sipër, të paraqesin dokumentat përkatëse pranë ZVAP Finiq-Dropull deri më dt. 24.01.2022, për trajtim sipas legjislacionit në fuqi nga Komisioni i Vlerësimit të ZVAP.

**DREJTORI**

**Ziso LLUCHI**

